



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 300/4 Prot

Tiranë, më 17/3/2022

VENDIM

Nr. 03, datë 17.3.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. (në vijim “ankuesja”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 300 Prot., datë 07.02.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet e-mail-it datë 27.01.2022, depozituar në adresën Argid.Alikaj@oshee.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Sa pika/qendra shërbimi të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group SH. A (në vijim “OSHEE Group” SH.A) ndodhen në territorin e Shqipërisë;
2. Sa është numri total i stafit të “OSHEE Group” SH.A që ofron shërbim për publikun në sportele;
3. Në këto godina që ofrohet shërbim për publikun, cili është statusi i pronësisë? Pra, sa janë godina në pronësi të “OSHEE Group” SH.A dhe sa janë marrë me qira nga një subjekt privat;
4. Sa është kostoja totale e qirasë vjetore që paguan “OSHEE Group” SH.A për mjediset e shërbimit që janë me qira? Kosto totale e qiramarrjes për 5 vitet e fundit, të specifikuar sipas secilit vit, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021.

Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 03.02.2022, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *"...Informacioni i kërkuar nuk konsiderohet informacion publik referuar dispozitave të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 7, por është informacion i cili lidhet ngushtësisht me aktivitetin financiar, përhapja e të cilit cënon interesat ekonomike dhe tregtare të shoqërisë. Gjithashtu, të gjitha të dhënat që klasifikohen si të dhëna publike sipas ligjit të sipërcituar, ndër të cilat edhe Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit me adresat e tyre të sakta, mund t'i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë "OSHEE Group" SH.A në linkun <https://oshee.al/adresat-e-qendrave-per-kujdesit-ndaj-klientit/>".*

Në vijim, pas përgjigjes së sipërcituar, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesja, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: *"Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur"*, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 300/1 prot., datë 09.02.2022 ka kërkuar nga Autoriteti Publik sqarime lidhur me zotërimin e dokumentacionit, si dhe argumentimin ligjor përkatës në lidhje me mosvënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1433/1 Prot., datë 15.02.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 300/2 Prot., datë 17.02.2022, ka sqaruar ndër të tjera se: *"...kërkesa për informacion nuk konsiderohet informacion publik referuar dispozitave të LDI, neni 7, por është informacion që lidhet ngushtësisht me aktivitetin financiar të shoqërisë. Në vlerësim të kërkesës, koordinatori për të drejtën e informimit, ka orientuar kërkuuesen me informacionin e publikuar në faqen zyrtare të internetit, lidhur me Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe adresat e tyre në link <https://oshee.al/adresat-e-qendrave-per-kujdesit-ndaj-klientit/>. Nga ana tjetër, sqarojmë se, referuar legjislacionit në fuqi, institucioni që ka për mision të prodhojë statistika asnjënjëse, transparente dhe të përditësuara, është Instituti i Statistikave (në vijim "INSTAT"). Në këtë kuptim, referuar kërkesave për informacion, por që nuk lidhen me detyrimet për të drejtën e informimit, kërkuuesja duhet t'i drejtohet këtij institucioni, i cili në respektim të parimeve statistikore, është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, statistika të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Së fundmi, sqarojmë se "OSHEE Group" SH.A, është shoqëri aksionare, me ofertë private me kapital 100 % shtetëror, me aksionar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe funksionon në mbështetje të Ligjit për Shoqëritë*

Tregtare, i ndryshuar, Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Në këtë kuadër, mbështetur në objektin e veprimtarisë, referuar Statutit të shoqërisë, sqarojmë se shoqëria “OSHEE Group” SH.A, nuk mund të ofrojë asnjë shërbim të kësaj natyre”.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesja pretendon se qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik me anë të kësaj shkrese, është në kundërshtim me LDI, në këto kushte ka vijuar me ankimin e regjistruar me nr. 300/3 Prot., datë 24.02.2022.

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin citohet se “*Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*”, me shkresën nr. 300/4 Prot., datë 25.02.2022, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 10.03.2022 me prezencën e ankueses dhe përfaqësuesit të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë, duke kërkuar nga Autoriteti Publik, t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni i kërkuar në formatin që ky i fundit e zotëron. Ndërkohë, përfaqësuesi i Autoritetit Publik citoi qëndrimin e OSHEE si dhe kërkoi të qartësohet lidhur me objektin e kërimit.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Zyra e Komisionerit i kërkoi përfaqësuesit të Autoritetit Publik qëndrimin përfundimtar lidhur me ankesën, brenda datës 11.03.2022.

Brenda afatit të vendosur nga Zyra e Komisionerit, si dhe deri në datën e këtij vendimi, nga ana Autoritetit Publik nuk pati asnjë reagim mbi qëndrimin përfundimtar në lidhje me vendosjen ose jo në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstaton se, lidhur me pikën 1 të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik ka vendosur në dispozicion linkun përkatës <https://oshee.al/adresat-e-qendrave-per-kujdesit-ndaj-klientit/>, në të cilën ndodhet informacioni i kërkuar. Rrjedhimisht, bazuar në pikën 2 të nenit 16 të LDI, në të cilin parashikohet se: “*Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni...*”, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nga Autoriteti Publik. Në këto kushte, ankesa lidhur me këtë pikë duhet rrëzuar.

Ndërkohë, lidhur me pikat 2, 3 dhe 4 të kërkesës për informacion, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Në shkronjën b) të pikës 1 të nenit 2, të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike”*.

Në kuptim të këtij parashikimi, “OSHEE Group” SH.A është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës, pavarësisht se informacioni i prodhuar është si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, legjislacion i cili nuk parashikon përjashtimin e “OSHEE Group” SH.A nga zbatimi i detyrimeve që burojnë nga LDI.

Nga shqyrtimi i kërkesës për informacion, Komisioneri vlerëson se, një pjesë e informacionit të kërkuar në pikën 2 të kërkesës për informacion përfshihet në kategorinë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë, bazuar kjo në shkronjat a) dhe d) të pikës 1 të nenit 7 të LDI, në të cilat parashikohet se: *“1. Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik; ...d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë...”*.

Ndërkohë, pikat 3 dhe 4 të kërkesës për informacion përfshihen në kategorinë e informacioneve që në kuptim të LDI, mund të vendoset në dispozicion nga Autoriteti Publik vetëm mbi bazën e një kërkesë.

Lidhur me pretendimin e ngritur nga Autoriteti Publik në kthim përgjigjen me nr. 1433/1 Prot., datë 15.02.2022, se *institucioni që ka për mision të prodhojë statistika asnjëherë, transparente dhe të përditësuara, është INSTAT*, pranohet që ky informacion disponohet nga ai, por jo në formatin e kërkuar.

Në këto kushte, bazuar në pikën 2, të neni 2 të LDI, ku parashikohet se: *“Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”*, Komisioneri vlerëson se, këto dokumente, përbëjnë informacion publik dhe bazuar në dispozitat e sipërcituara duhet të vendosen në dispozicion të kërkuarit/ankuesit në formatin e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë kufizimet sipas nenit 17 të LDI.

Ndërkohë lidhur me argumentin se, *referuar kërkesave për informacion, por që nuk lidhen me detyrimet për të drejtën e informimit, kërkesja duhet t'i drejtohet INSTAT*, Komisioneri e gjen të pabazuar për shkak se Autoriteti Publik nuk rezulton që të ketë trajtuar kërkesën për informacion, në bazë të pikave 2 dhe 3 të nenit 12 të LDI, në të cilën parashikohet se:

2. *“Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin.*

3. *Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuuesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.”*

Sa më sipër, parashikohet gjithashtu dhe në germën “d”, të pikës 2, neni 10 i LDI, sipas të cilit *“koordinatori për të drejtën e informimit dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.*

Si përfundim, në pikën 3 të nenit 3 të LDI parashikohet se, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksonimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, neni 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës nr. 300 Prot., datë 07.02.2022 të znj. kundër Autoritetit Publik “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.*
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit bazuar në kërkesën për informacion datë 27.01.2022, në formatin e zotëruar, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht: (2. *Sa është numri total i stafit OSHEE group sh.a që ofron shërbim për publikun në sportele; 3. Në këto godina që ofrohet shërbim për publikun, cili është statusi i pronësisë? Pra, sa janë godina në pronësi të OSHEE dhe sa janë marrë me qira nga një subjekt privat; 4. Sa është kostoja totale e qirasë vjetore që paguan Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për mjediset e shërbimit që janë me qira? Kosto totale e qiramarrjes për 5 vitet e fundit, të specifikuar sipas secilit vit, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021.), brenda datës 25.3.2022.*

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 17.3.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

